



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e  
Komuniteteve dhe Kthim**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 19/09**

**Prishtinë, më 17.03.2009, ora 13:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Bojan Stojanović, Sanije Aliaj, Numan Balić, Hafize Hajdini, Kosara Nikolić, Müfera Şinik, Enis Kervan. Xhevdet Neziraj, Zylfi Merxha, Hetem Arifi, Zafir Berisha, Sadik Idriz, Mursejl Haljilji.

Gjithashtu të pranishëm ishin: monitruues nga Zyra e Presidentit, Zyra e Presidentit, KDI, nga Gazeta “Bota Sot”.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

**Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 27.2.2009
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinore, me amendamente
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-104 për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nukleare, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-090 për partneritetet publik – privat dhe Koncesione për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre me raportin komisionit funksional Komisioni për Buxhet e Financa, me amendamente
6. Të ndryshme.

**Kryesuesi**, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendit i ditës miratohet pa ndryshime.

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 27 shkurt 2009**

**Kryesuesi**, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e dt. 27 shkurt 2009, u miratua pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi Projektligjit nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinore, me amendamente**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

**Zylfi Merxha**, si anëtar i komisionit funksional, theksoi se nuk ka vërejtur se Projektligji i cenon interesat dhe të drejtat e komuniteteve, prandaj kërkoj t'i rekomandojnë Kuvendit miratimin e tij.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, Komisioni nxori këtë:

### **R E K O M A N D I M**

**I.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

**II.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-104 për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nukleare, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

**Zylfi Merxha**, edhe lidhur me këtë Projektligji ,theksoi se nuk ka vërejtur dispozita që i cenojnë interesat dhe të drejtat e komuniteteve, prandaj kërkoj t'i rekomandojnë Kuvendit miratimin e tij.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, Komisioni nxori këtë:

### **R E K O M A N D I M**

**I.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 03/L-104 për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nukleare dhe ka

konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

- II.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

#### **5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/I-090 për partneritetet publik – privat dhe koncesione për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre me raportin komisionit funksional Komisioni për Buxhet e Financa, me amendamente**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

**Kosara Nikolić**, theksoi se është një gabim teknik në amendamentin 5, paragrafi 2.3 ku dy herë është përsëritur fjalia “**sporazum za javno – privatno partnerstvo**“ në versionin serbisht.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se me dhjetë vota Për, një Kundër (Z.Xhevdet Neziraj) dhe asnjë Abstenim, Komisioni nxori këtë:

### **R E K O M A N D I M**

- I.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 03/I-090 për partneritetet publik – privat dhe koncesione për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

#### **6. Të ndryshme**

**Kryesuesi**, njoftoi se vizita e planifikuar në Komunën e Ferizajit ka dështuar për shkak se autoritetet komunale nuk kanë shprehur gatishmërinë të takohen me ne, duke dhënë arsyeje të ndryshme. Në vazhdim duke komentuar disa vërejtje për punën e komisionit, theksoi se do të punojë që t’iu shmangen grindjeve dhe mospajtimeve të mëdha në komision. Më pas njoftoi për kërkesën e Kryetarit të Kuvendit, që komisioni të jep rekomandimet lidhur me Projektligjin për Banesat. Konform kësaj kërkesë ka kontaktuar me përfaqësuesit e ICO dhe ka marrë premtimin se do të sjellin propozimet e tyre. Nëse kjo nuk ndodh brenda pesëmbëdhjetë ditësh, të njëjtin do ta radhis për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Komisionit.

**Numan Balić**, lidhur me dështimin e vizitës në Ferizaj, kërkoi që të bisedohet me Kryesinë e Kuvendit, dhe të kërkohet që ajo t’i drejtohet komunës në fjalë për mosgatishmërinë për të pranuar

komisionin parlamentar. Ndërsa për çështjen e Projektligjit për banesat, theksoi se duhet të presim propozimet e ICO.

**Enis Kervan**, kërkoi të vazhdohet në zbatimin e planprogramit e miratuar të komisionit në realizimin e vizitave në teren. Propozoi që të organizohet një takim i përbashkët me përfaqësuesit e zyrave për komunitetet në nivelet lokale dhe me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim për të diskutuar për problemet që ballafaqohen ata.

**Hafize Hajdini**, theksoi se dështimi i realizimit të vizitës në Ferizaj ka ndodhur për shkak se Kryetari në atë kohë ka realizuar një vizitë në Francë, ndërsa nënkryetari nuk ka shprehur gatishmërinë për të na pritur. Falënderoi kryetarin e komisionit dhe Ministrin e Ministrisë për Komunitete që vizituan fshatin Dubravë dhe komunitetin ashkali, dhe duke parë kushtet e vështira që jetojnë ata shprehu shpresën se do t'i ndihmohet atij komuniteti.

**Xhevdet Neziraj**, theksoi se nëse nuk na presin autoritetet komunale në Ferizaj, mund ta realizojmë një vizitë në ndonjë komunë tjetër. Lidhur buxhetin për komunitete në të kaluarën nuk është menaxhuar mirë, prandaj shprehu shpresën që këtë vit ndarja e buxhetit për komunitete të bëhet ashtu si ju takon atyre dhe në bazë të projekteve konkrete. Kritikoi strategjinë e Qeverisë të hartuar së bashku me OSBE-në për integrimin e komitetieteve RAE, duke mos i identifikuar komunitetet veç e veç si rom, ashkali dhe egjiptas. Duke mos pasur statistika të sakta për komunitetet, kjo ka ndikuar në ndarjen jo të drejtë të buxhetit për komunitetet e caktuar.

**Kryesuesi**, duke iu përgjigjur z. Kervan, theksoi se deri në muajin Maj, komisioni do të organizojë një konferencë së bashku me përfaqësuesit e komunitetet në nivelin lokal, në të cilën do të ftohet edhe Kryeministri dhe Ministri i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa. Ministria përkatëse po përgatit strategjinë për komunitete, si Komisioni ti identifikojmë prioritetet tona dhe në këtë formë i ndihmojmë Ministrisë në hartimin e kësaj strategjie, nga e cila do të përfitojnë të gjithë komunitetet. Premtoi se javën e ardhshme do të mbahet një takim me Ministrinë e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Mbledhja përfundoi në ora 13:40

**Përgatitur nga**  
**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit,**

**Bojan STOJANOVIĆ**